

UDHËZIM
Nr.849, datë 16.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.548, DATË 2.8.2007 “PËR SHOQËRITË ANONIME “NË LIKUIDIM E SIPËR”, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, seksioni V “Likuidimi”, ligji nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.548, datë 2.8.2007 “Për shoqëritë anonime “në likuidim e sipër”, me kapital tërësisht shtetëror”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 fjala “blihen” zëvendësohet me fjalën “shpërndahen”.

2. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë:

9. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, truallit dhe makinerive e pajisjeve të jetë vlera e përcaktuar nga ekspertë vlerësues të emëruar nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë. Ekspertët vlerësues do t’i referohen çmimeve të tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik dhe vlera e mjeteve të xhiros së objektit përkatës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli**